



INFORMOHU DHE VEPRO!

**RESPEKTIMI I TË DREJTAVE
TË VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE
TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT NJERËZOR**

Broshurë për punonjësit e policisë së shtetit

INFORMOHU DHE VEPRO!

**RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË
VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË
MUNDSHME TË TRAFIKIMIT NJERËZOR**

Broshurë për punonjësit e policisë së shtetit

Vlorë, 2013

Design & Layout: Grafika Elzana

Shtypur në shtypshkronjën: albPAPER

Tirazhi: 500 kopje

© Të gjitha të drejtat të rezervuara: Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

Vlorë 2013

Mbështetur nga projekti i financuar nga USAID “Fuqizimi i Kapaciteteve Shqiptare Kundër Trafikimit” i zbatuar nga IOM

SHËNIM

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve apo të Qeverisë së SHBA-ve dhe/ose të Organizatës Nderkombetare për Migracionin (ONM).

Parathënie

Të nderuar punonjës të policisë së shtetit,

Në shërbim dhe vijimësi të një marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe Qendrës Psiko-sociale “Vatra” në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e viktimave të këtij krimi, në dhjetor 2012 ne nënshkruam një marrëveshje dypalëshe të fokusuar në informimin e barabartë dhe komunikim bazuar tek të drejtat mes punonjësve të policisë së shtetit dhe viktimat e mundshme apo viktimat e trafikimit.

Zbatimi i kësaj marrëveshje fillon me prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve informative të mbështetur nga IOM me fonde të USAID dhe vijon me përdorimin në shkallë të gjerë e të vazhdueshme të këtyre materialeve.

Në këtë kornizë institucionale, kemi kënaqësinë t’ju vemë në dispozicion broshurën “INFORMOHU DHE VEPRO!” që do t’ju ndihmojë në punën tuaj të përditshme në zbatimin e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e personave viktimat të mundshme apo viktimat të trafikimit.

Në këtë broshurë prezantohet dhe analizohet mënyra se si persona të ndryshëm kanë rënë në kontakt dhe janë ndihmuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe strehëzat e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik të përbërë nga Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Qendra Psiko - Sociale “Vatra”, “Tjetër Vizion” dhe “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Për arsye të ruajtjes së konfidencialitetit të këtyre personave ende në proces ndihme, përshkrimet janë me inicialet të rreme dhe jo me emrat apo inicialet e vërtetë.

Qëllimi i prezantimit dhe analizimit të këtyre rasteve është evidentimi i praktikave të mira që strukturat e policisë së shtetit kanë në respektimin e të drejtave të personave si shtetas dhe si persona të dyshuar apo identifikuar viktime të trafikimit si edhe të jepen referenca dhe udhëzime konkrete për përmirësimin e këtyre praktikave kur është e nevojshme.

Ne deklarojmë me përgjegjësi të plotë, se informacioni i dhënë në përshkrimet e rasteve është ashtu siç ne e dimë, pa asnjë shtrembërim.

Në katër prej këtyre rasteve, informacioni është paraqitur si përmbledhje dhe tregim në vetën e tretë, sipas intervistave që punonjësit e KKSAT u kanë bërë personave, tashmë përfitues të shërbimeve, posaçërisht për këtë broshurë. Intervistat janë përqëndruar vetëm në segmentin e identifikimit dhe referimit, aty ku duhet të nisë dhe nis rikuperimi i të drejtave. Në këto përmbledhje jemi përpjekur të sjellim faktet kryesore, ndjesitë dhe perceptimet individuale të këtyre personave dhe për të sqaruar më mirë situatën na është dashur të plotësojmë me informacion të vërtetë në dijeninë tonë. Në njërin prej rasteve, informacioni është dhënë sipas përshkrimit që një punonjëse e KKSAT i ka bërë një rasti, kur kjo e fundit është thirrur të përfshihet në identifikimin dhe ndihmën për të mitur, viktime të mundshme të trafikimit.

Analiza e përshkrimeve është bërë nga specialistë të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ekspertë antitrafik nga IOM dhe Vatra, përfaqësues të KKSAT, ARSIS dhe përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror.

Qendra Psiko - Sociale "Vatra"

KAPITULLI I

Të drejtat prej të cilave udhëhiqemi

Të drejtat prej të cilave udhëhiqemi në punën e përditshme me persona të mitur e të rritur, të cilët mund të jenë viktimat të mundshme të trafikimit burojnë nga Konventat për të drejtat e njeriut dhe detyrime të tjera ndërkombëtare dhe vendase. Në këtë broshurë do të fokusohemi kryesisht tek ato të drejta të cilat rrezikohen më shpesh gjatë procesit të pritjes, identifikimit dhe referimit të personave dhe mbi bazën e të cilave janë hartuar edhe Procedurat Standarde për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV)¹. Disa prej tyre janë:

1. E drejta për trajtimin me dinjitet në çdo hap të procesit të pritjes, identifikimit dhe referimit.
2. E drejta për mos diskriminim mbi gjininë, racën, fenë, etninë, gjuhën, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësinë prindërore.
3. E drejta për informim të plotë dhe të vërtetë gjatë procesit të pritjes, identifikimit dhe referimit mbi :
 - Pozicionin e punonjësit të policisë së shtetit që bie në kontakt, mbledh informacion, interviston apo referon atë.
 - Ndhimën dhe mbrojtjen e veçantë, llojin dhe kushtet e ndihmës.
 - Të drejtën e viktimave të trafikimit për kompensim;

¹ “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit në Njerëz. VKM Nr. 582, datë, 27/07/2011.

4. E drejta e viktimës për t'u referuar tek ndihma pavarësisht nga nga kallzimi/ bashkëpunimi i saj me organet e drejtësisë.
5. E drejta për t'u përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarit, kurdoherë që paraqitet e nevojshme dhe plotësohen kriteret e ligjit.
6. E drejta e personave të mitur për t'u trajtuar në përputhje me të drejtat e parashikuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Fëmijëve.
7. E drejta e viktimës dhe kujdestarit të tij/saj për të zgjedhur lirisht dhe pa pasoja llojin e ndihmës dhe akomodimit të informuar në mënyrë të plotë dhe të vërtetë.
8. E drejta për të mbrojtur në çdo rast jetën private dhe identitetin².
9. E drejta për t'u identifikuar dhe referuar në kohën më të shpejtë të mundshme, duke respektuar afatet ligjore dhe shmangur dhe minimizuar vonesat, lodhjen dhe ritraumatizimin e tyre.

² Të dhënat personale të tyre ruhen dhe përdoren në përputhje me Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve, për sa i përket Proacesimit Automatik të të Dhënave Personale, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”.

KAPITULLI II

Praktika dhe udhëzime të respektimit të të drejtave të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimi gjatë procesit të pritjes, identifikimit dhe referimit të tyre nga strukturat e Policisë. - Studime rasti

Rasti 1

Shtetësja shqiptare A. ishte shfrytëzuar seksualisht, në shtetin X. për rreth katër vjet. Edhe pse kishte frikë nga reagimi i prindërve dhe nuk ishte e sigurt nëse do të merrej në mbrojtje nga shteti apo jo, vendosi të kthehej në Shqipëri dhe të denonconte shfrytëzuesin e saj. Nëpërmjet të afërmve të saj, kontaktoi me qendrën e rehabilitimit Y., në Shqipëri. Qendra njoftoi Strukturën e Kundër Trafikeve të Paligjshme pranë Drejtorisë së Policisë në qytetin E. (vend i origjinës së vajzës) dhe e informoi atë në lidhje me situatën në të cilën ndodhej vajza si edhe vendimin e saj. Si Qendra ashtu dhe policia e këtij qyteti ranë dakord të nisen për të pritur shtetasen A. në kufi.

Ky informacion iu komunikua shtetases (nëpërmjet të afërmve të saj), që ndërkohë ishte duke u kthyer vetëm, nga shteti X, për në Shqipëri. Policia e qarkut E, lajmëroi si policinë kufitare, ashtu dhe Drejtorinë e Policisë së qarkut kufitar, për mbërritjen e shtetases nga shteti X.

A. mbriti në kufi, disa orë më shpejt se punonjësja sociale e Qendrës dhe oficeri i policisë së qytetit E. Me mbërritjen në

kufi, polici i kufirit e ka shoqëruar në një zyrë duke lajmëruar një tjetër punonjës. Ky i fundit e pyet se çfarë problemi kishte dhe A. i thotë që do të bënte një denoncim, pa i treguar se c’lloj denoncimi dhe se dëshironte që këtë veprim ta kryente në policinë e qytetit të saj, ku e prisnin dhe familjarët.

Pasi bëri një telefonatë, oficeri i tha të priste pak, sepse do të vinte dikush tjetër nga Drejtoria e Policisë së qytetit më të afërt me kufirin, për t’u marrë me çështjen e saj. Pas 10 minutash oficeri e shoqëron në një dhomë, ku ajo do të priste deri sa të vinin ta merrnin. Dhoma ndodhej jashtë godinës, diku më larg dhe A. pati mundësi të kryente nevojat personale. Pas rreth 20 minutash, u paraqitën dy policë civilë, të cilët pasi firmosën disa dokumente e morën me vete.

Policët nuk u prezantuan, por e pyetën shtetasen për nevojat ushqimore. Pasi hipën në një makinë normale, pa simbole të policisë, u nisën drejt Drejtorisë së Policisë (së qytetit më të afërt). Gjatë rrugës, njëri nga punonjësit e policisë që e shoqëronte insistoi të dinte më shumë për denoncimin duke i thënë se ishte njësoj si në makinë, si në zyrë, por A. i tha se do të fliste kur të shkonin në Polici A. i tregoi se kishte kontaktuar me një qendër, nëpërmjet të afërmeve të saj dhe një punonjëse e kësaj qendre, së bashku me oficerin e policisë së qytetit të saj do ta prisnin në polici.

Kur mbërritën në Drejtorinë e Policisë, në hyrje e priti një tjetër punonjës policie, i cili pasi bisedoi me policin që e shoqëronte, e akomodoi derisa të vinte shefi. Pas disa minutash erdhi një oficer policie dhe u prezantua si shefi i zyrës. Ai e mori në zyrën e tij dhe shtetasja aty u takua me punonjësen e qendrës që po priste e ulur. Kjo e fundit u prezantua dhe u ul afër saj. Së bashku me të ishte edhe një polic nga vendi i origjinës, që kishte ardhur me punonjësen e qendrës.

Në zyrë hynë edhe 3 apo 4 policë të tjerë. A. tregon se shikimet e tyre, të cilat ishin drejtuar drejt saj e kishin vënë

në siklet. Dera u hap disa herë, pasi dy punonjës policie dilnin dhe hynin për punët e tyre. Ishte shumë vonë, kishte kaluar mesnata dhe ajo ndihej shumë e lodhur dhe nuk mund të përqëndrohej.

Oficeri i policisë që u prezantua si shefi, filloi ta pyeste edhe në prani të të tjerëve për identitetin, origjinën dhe historinë e saj. **A.** i përgjigjej shkurtimisht, pasi kishte një ndjenjë turpi ndërkohë që tregonte historinë e saj. Oficeri i policisë e pyeste për personin që e kishte shfrytëzuar dhe për kohën e shfrytëzimit. Më pas polici hapi kompjuterin dhe po fliste me **A.** -në për të identifikuar personin për të cilin ajo kishte rrëfyer. Pasi e gjetën me foto, i treguan, nëse ishte ai apo jo dhe filluan ta pyesnin përsëri se në ç'rrethana shtetasja ishte lidhur me të, përse kishte pritur kaq shumë kohë që të denonconte.

Më pas, shefi i tha njërit prej punonjësve të policisë të pranishëm, që do të fillonin me pyetjet dhe ai do të mbante shënim në kompjuter gjithë kallëzimin. **A.** nuk po e kuptonte se çfarë po ndodhte, mendoi se denoncimin do ta bënte pranë Policisë së qytetit të saj, por gjithashtu mendoi se ato ishin rregullat dhe ajo duhet t'i ndiqte.

Më pas, punonjësja sociale e Qendrës Y. i tha shefit që të bisedonin së bashku. Ajo doli në korridor me shefin dhe me punonjësën e policisë që vinte nga policia e qytetit të saj dhe pas rreth 10 minutash hyri brenda duke i komunikuar që do të largoheshin për në qendrën e rehabilitimit Y, për shkak të orës së vonë dhe të nesërmen do të fillonin procedurat në policinë e qytetit të saj. Punonjësja e informoi disa minuta për qendrën, akomodimin e parë dhe ndihmën e parë.

Pasi u firmosën disa dokumente, u nisën drejt qytetit ku ishte qendra. Ndoshta gjatë gjithë kësaj kohe kishte kaluar rreth 1 orë e gjysmë pas mesnate dhe **A.** ndihej e lodhur...

Praktika pozitive që vihen re në punën e policisë:

- Gatishmëria e Policive të Qarqeve dhe Policisë së Kufirit për t’i ardhur në ndihmë në kohën më të shpejtë të mundur shtetases A.
- Respektimi i të drejtës për plotësimin e nevojave bazë (ushqim, kujdes personal).
- Shoqërimi i shtetases për në Qendrën e Rehabilitimit në kushte të sigurta, shoqëruar nga oficerë policie, si dhe punonjës social.
- Kujdesi për plotësimin e dokumentacionit

<i>PROBLEMATIKA</i>	<i>SI DUHET VEPRUAR</i>
<p>Nuk është respektuar e drejta për informim për shtetasen gjatë procesit të identifikimit. (Punonjësit e policisë së qarikut B. nuk janë prezantuar tek shtetasja A. në kontaktin e parë me të dhe nuk e kanë informuar në lidhje me veprimet që kryen policia.)</p>	<p>Sipas rregullave të etikës së Policisë së Shtetit, që reflektohen edhe në PSV-të, çdo punonjës policie, para çdo veprimi administrativ apo procedural, duhet t’i prezantohet shtetasit/shtetases që ka përpara, duke i shpjeguar gjeneralitetet e veta, si edhe pozicionin përkatës. Gjithashtu, për çdo veprim apo mosveprim të tijin/sajën, punonjësi i policisë duhet ta informojë shtetasin/shtetasen për të drejtat që ai/ajo ka dhe ta asistojë atë në përmbushjen e tyre dhe të sigurohet për plotësimin e tyre.</p>
<p>Shoqërimi i shtetases A. me makinë pa logo apo targa policie, ka ngjallur mosbesim tek ajo.</p>	<p>Në mënyrë që shtetasit të ndihen të sigurtë e të mbrojtur, në mënyrë të vecantë kur ata dëshirojnë me vullnetin e tyre të bashkëpunojnë me drejtësinë, duhen marrë masa të veçanta për t’i siguruar këto kushte.</p>

<p>Drejtimi i pyetjeve për shtetasen A, nga ana e policëve në makinë përbën shkelje të etikës profesionale.</p>	<p>Procesi i pyetjeve kundrejt shtetasve që bien në kontakt me policinë, në çdo rast dhe rrethana duhet realizuar në kohën dhe vendin e duhur për këtë proces.</p>
<p>Kryerja e intervistimit të shtetasës A. në prani të policëve të tjerë që hyjnë e dalin në mjedisin ku po realizohet ky proces, përbën shkelje të konfidencialitetit.</p>	<p>Në bazë të PSV-ve, gjatë intervistës formale duhet të jenë prezent vetëm punonjësi i sektorit të trafikeve të paligjshme të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, punonjësi social i Shërbimit Social Shtetëror, si edhe punonjësja sociale e qendrës ku personi trajtohet / në rast të të miturit, psikologu shoqëruar nga prindi/kujdestari ligjor.</p>
<p>Procesi i denoncimit ka nisur gjatë orëve pasmesnate, me mbërritjen e shtetasës në Shqipëri. Nuk është respektuar gjendja aktuale e shtetasës A.</p>	<p>Në bazë të PSV-ve me këtë shtetase duhej të ishte kryer procedura e identifikimit fillestar në kufi, në mënyrë që me pas të procedohej menjëherë me referimin për asistencë dhe akomodim, duke lënë kohën e mjaftueshme për kallzim apo intervistë formale sipas rastit. Gjithashtu, në bazë të PSV-ve, intervista formale dhe procesi i denoncimit/marrjes së kallëzimit, nuk duhen bërë në të njëjtën kohë.</p>
<p>Mosinformimi i Autoritetit Përgjegjës menjëherë pas marrjes së informacionit për kthimin e shtetasës në Shqipëri. .</p>	<p>PSV kërkojnë informimin e Autoritetit Përgjegjës në çdo rast kur një person viktimë/ viktimë e mundshme e trafikimit kërkon të kthehet. Është Autoriteti Përgjegjës ai që koordinon pritjen.</p>

Rasti 2

E. është një shtetase shqiptare, e rritur, ish viktimë e shfrytëzimit seksual, në një prej vendeve fqinje. Pasi denoncoi në policinë e vendit të destinacionit ku dhe u shfrytëzua, shtetasja u kthye në Shqipëri. Kur u paraqit në zyrat e policisë kufitare, në Shqipëri, qëndroi për rreth 4 orë, në një zyrë ku ishin dhe 3 oficerë të policisë së kufirit, të cilët nuk u prezantuan, por filluan të pyesnin **E.-në** për historinë e saj.

E. ndihej vazhdimisht e frikësuar dhe në ankth, sepse nuk e kishte të qartë se çfarë do të ndodhte më pas me të. Pas 4 orësh, në zyrën kufitare u paraqitën përfaqësues nga policia e qytetit më të afërt, për ta marrë dhe për ta çuar në zyrat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut.

Rreth orës 01:00 pas mesnate shtetasja mbriti në ambientet e Drejtorisë së policisë së atij qyteti dhe shprehet se ishte shumë e kënaqur nga pritja e parë. Oficerët e policisë u treguan të vëmendshëm ndaj nevojave të saj bazë, i ofruan për të ngrënë dhe patën një komunikim të mirë me të.

Në zyrën ku ndodhej ishin 3 oficerë policie dhe për njërin prej tyre, shtetasës iu krijua përshtypja se ishte shef komisarati. Gjithashtu i pranishëm ishte edhe një përfaqësues i Shërbimit Social Shtetëror. Shtetasja shprehet se intervista që u pasua në prani të tyre ishte shumë e gjatë dhe e lodhshme.

Pavarësisht se **E.** i tha intervistuesve se nuk donte të lidhej me familjen, ata u përpoqën ta bindnin të kthehej në familje dhe madje u lidhën me familjarët në telefon. Pasi mbaroi intervista i thanë se atë natë do të qëndronte në mjediset e policisë.

Të nesërmen paradite, në zyrë u paraqit një punonjëse sociale, nga një qendër sociale, e cila i shpjegoi se si funksiononte qendra. **E.** pranoi të shkonte në qendër me vullnetin e saj të lirë, për të marrë shërbimet e ofruara atje, pasi nuk donte të kthehej pranë familjes së origjinës, për shkak të marrëdhënieve problematike me ta.

Pasi u plotësuan dokumentet përkatëse shtetasja u shoqërua për në qendrën e rehabilitimit.

Praktika pozitive që vihen re në punën e policisë:

- Respektimi i nevojave bazë për shtetasen E. nga ana e oficerëve të policisë.
- Respektimi i rregullave për kryerjen e procesit të identifikimit formal për shtetasen në prani të punonjësit social të shërbimit social shtetëror.
- Referimi, nga ana e punonjësve të policisë, për akomodim dhe asistencë pranë një qendre sociale.

<i>PROBLEMATIKA</i>	<i>SI DUHET VEPRUAR</i>
Nuk është respektuar e drejta për informim për shtetasen gjatë procesit të identifikimit. (Punonjësit e policisë nuk janë prezantuar tek shtetasja E. në kontaktin e parë me të. Ajo hamendëson për pozicionet në detyrë të tyre. Gjithashtu, ata nuk e kanë informuar atë përpara kryerjes së intervistës formale në lidhje me ç'ka po ndodhte.)	Në bazë të PSV-ve, dhe rregullave të etikës së Policisë së Shtetit, çdo punonjës policie, para çdo veprimi administrativ apo procedural, duhet t'i prezantohet shtetasit/shtetasës që ka përpara, duke i shpjeguar gjeneralitetet e veta, si edhe pozicionin përkatës. Gjithashtu, për çdo veprim apo mosveprim të tijin/sajën, punonjësi i policisë duhet ta informojë shtetasin/shtetasen për të drejtat që ai/ajo gëzon dhe ta asistojë atë në gëzimin e tyre dhe të sigurohet për respektimin e tyre.
Gjatë intervistës formale kanë qëndruar prezent punonjës të tjerë policie përveç specialistëve që duhet të zhvillojnë intervistën formale.	Në bazë të PSV-ve, gjatë intervistës formale duhet të jenë prezent vetëm punonjësi i sektorit të trafikeve të paligjshme të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, punonjësi social i Shërbimit Social Shtetëror, si edhe punonjësja sociale e qendrës ku personi trajtohet, në rast të të miturit, psikologu shoqëruar nga prindi/kujdestari ligjor.

<p>Qëndrimi në mjediset e policisë për orë të tëra gjatë natës dhe për më tepër fjetja në ato mjedise.</p>	<p>Në bazë të PSV, Policia e Kufirit duhej të bënte identifikimin fillestar të shtetasës. Menjëherë pas identifikimit fillestar shtetasja duhet të ishte referuar pranë Seksionit më të afërt Kundër Trafiqueve të Paligjshme.</p> <p>Specialistët e SKTP, për shkak të kohës kur kanë marrë kontakt me VMT duhet të organizonin menjëherë referimin e saj pranë një qendre sociale e më pas të vendosnin për identifikimin formal dhe nëse ekziston vullneti i lire i saj edhe për kallzim. Për çdo veprim të kryer nga ana e tyre duhet të njoftohet menjëherë Autoriteti Pergjegjës.</p>
<p>Njoftimi i familjarëve nga ana e policisë jashtë dëshirës së shtetasës. Mos vlerësimi i marrëdhënieve të saj me familjen.</p>	<p>Lajmërimi i familjarëve në rastet e rritur/a është në dëshirën e personit. Në rastin e të miturit/miturës, oficeri i policisë njofton familjen, në rastin kur kjo e fundit nuk përbën rrezik për të miturin/miturën.</p>

Rasti 3

Xh. është një shtetase shqiptare, e cila ka punuar jashtë vendit dhe është shfrytëzuar nga një person tjetër, për punë të detyruar. Pasi u largua nga personi që e shfrytëzonte, ajo u kthye në Shqipëri, por familja e origjinës nuk e pranoi. Filloi punë në një qytet tjetër, por duke qenë vetëm pati vështirësi dhe shumë nevojë për ndihmë. Për këtë arsye i drejtohet një organizate, për të cilën kishte dëgjuar nga teza e saj.

Kjo organizatë, pas kontaktimit me shtetasen, identifikoi disa tregues të trafikimit dhe e referon tek një qendër tjetër, për të cilën kjo organizatë kishte informacion se ofronte shërbime për këtë target grup.

Qendra Y. e intervistoi dhe e identifikoi Xh. si viktimë të mundshme të trafikimit të personave për punë të detyruar. Punonjësja e Y., e informoi për të drejtat si dhe në lidhje me programin që organizata ofronte në ndihmë dhe mbështetje të saj. Xh. pranoi të ndihmohej nga organizata Y. dhe u akomodua pranë saj.

Paralelisht me adresimin e nevojave bazë, punonjëset e organizatës e informuan Xh. mbi të drejtën për të denoncuar shfrytëzuesin dhe procedurat e identifikimit formal. Xh. pranoi menjëherë, për të ndjekur procedurat e identifikimit formal, si dhe për të denoncuar shfrytëzuesin, edhe pse tezja e saj insistonte se nuk ishte ide e mirë. Xh. kishte dëshirë të tregonte se çfarë i kishte ndodhur dhe mundësisht që personi që i kishte bërë keq, të mos guxonte ta bënte këtë gjë me persona të tjerë.

Në polici Xh.-në e shoqëroi një nga punonjëset e organizatës. Në Drejtorinë e Policisë, në zyrën ku e shoqëruan, përveç një punonjësi të Seksionit Kundër Trafiqeve të Paligjshme ishte edhe një përfaqësuese e Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH).

Xh. kishte shumë ndrojtje për të folur. Gjatë intervistës i dukej sikur polici nuk po besonte ato që ajo po tregonte dhe mbase vërtet ashtu ishte. Ajo mendonte se nëse nuk do ishte punonjësja e organizatës së ndihmës dhe përfaqësuesja e SHSSH, ndoshta polici nuk do t'i kishte dhënë rëndësinë e duhur historisë së saj dhe do të kishte mbaruar shumë shpejt punë me të.

Gjatë intervistës, në zyrë u zhvillua një debat i madh për faktin nëse dikush që ishte shfrytëzuar për punë mund të quhej viktimë trafikimi. Punonjësi i policisë që realizonte intervistën nuk e njihte këtë lloj trafikimi. Kur ishte realizuar më shumë se gjysma e intervistës, punonjësit të policisë iu desh të largohej dhe në vend të tij erdhi dikush tjetër, të cilit filluan t'i shpjegonin shkurtimisht çfarë po ndodhte. Xh. ndihej në siklet, e lodhur dhe konfuze. Ajo filloi të tregonte çdo gjë nga e para, deri sa intervista përfundoi...

Praktika pozitive që vihen re në punën e policisë:

- Organizimi i intervistës formale në prani të SHSSH dhe punonjësesh sociale të qendrës, në zbatim të PSV-ve.

PROBLEMATIKA	SI DUHET VEPRUAR
<p>Diskutimi mes profesionistëve në prezencë të personit të interesuar.</p>	<p>Në bazë të PSV-ve, specialisti i SKTP dhe punonjësi i ZRSHSSH duhet të marrin informacion nga punonjësi i ndihmës që e shoqëron dhe e njeh rastin, lidhur me rrethanat dhe treguesit mbi bazën e të cilave është arritur në përfundimin se personi është viktimë e mundshme e trafikimit. Përveç kësaj ata duhet të bëjnë, me ndihmën e menaxherit të rastit, analizën e intervistës formale dhe konkludimin në lidhje me të, në një ambient tjetër nga ai ku u zhvillua intervista dhe ku ndodhet personi i intervistuar.</p>
<p>Ndryshimi i oficerit intervistues.</p>	<p>Në bazë të PSV-ve, në lidhje me identifikimin formal të viktimës së trafikimit, apo/edhe në bazë të KPP, në lidhje me dhënien e deklaramit/kallëzimit, të dy këto veprime procedurale të rëndësishme kryhen vetëm nga një oficer policie, i cili ka dhe të drejtën e firmës në dokumentin përkatës.</p> <p>Nëse oficerit të policisë që po bën intervistën i duhet të largohet për arsye pune, kjo duhet konsideruar si mosplotësim i kushteve për intervistë formale, dhe PSV-të kërkojnë të ndërpritet intervista dhe të caktohet një kohë tjetër për të.</p>
<p>Mosnjohja shfrytëzimit në punë të detyruar si formë e trafikimit të qënieve njerëzore.</p>	<p>Duhet kuptuar se trafikimi është një vepër penale e rëndë, që në thelb të tij ka shfrytëzimin e personit. Shfrytëzimi përfshin, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, vënien në shërbim ose heqjen e organeve (Neni 110/a i KP).</p>

	Në PSV ka një seksion me formate intervistash dhe dokumentacioni, dhe formati i intervistës formale për të rritur udhëzon se çfarë informacioni duhet mbledhur për identifikimin e shfrytëzimit të punë të detyruar.
Kallzimi është dekurajuar	Qëllimi i intervistës formale është të identifikojë nëse personi është trafikuar dhe të bëjë një plan ndihme e mbrojtje të përshtatshëm për të, që përfshin edhe dëshirën që të vihet drejtësia në vend. PSV-të lejojnë që nëse ka dyshime për vërtetësinë apo koherencën e informacionit të dhënë nga viktima e mundshme gjatë intervistës, mund të kërkohet kohë apo edhe një intervistë tjetër për të qartësuar apo verifikuar informacionin.

Rasti 4

Punonjësja sociale e një prej qendrave riintegruese, së bashku me psikologun e qendrës, u thirrën nga policia për të dhënë mbështetjen psiko sociale për tre të mitur të cilët ndodheshin në Drejtorinë e Policisë së Qarkut. Të miturit ishin kapur në flagrancë nga Policia, duke kryer aktin e vjedhjes së pasurisë së dikujt.

Kur punonjësja sociale dhe psikologu u paraqitën atje, në zyrë, ndodheshin të 3 fëmijët, të cilët ishin të moshës 9 deri në 12 vjeç, oficeri i zyrës së krimeve, prindërit e tyre. Më pas erdhi edhe avokati.

Nuk pati vonesa apo probleme gjatë marrjes në pyetje. Fëmijët u pyetën nga oficeri i policisë së krimeve, në prani të psikologut, avokatit, punonjësit social dhe prindërve të tyre. Secili nga fëmijët dhe prindërit, u sqaruan për procedurat dhe qëllimin e marrjes në pyetje. Secili fëmijë u pyet më vehte. Sipas punonjësës sociale fëmijët u trajtuan mirë dhe

ishin të qetë gjatë gjithë kohës së deklarimit , por gjatë kësaj kohe në zyrë hynin dhe dilnin edhe punonjës policie të tjerë.

Gjatë procesit të pyetjeve nga policia, fëmijët deklaruan se ishin detyruar të kryenin vjedhje në shtëpi të ndryshme, duke u kërcënuar dhe duke u mbikëqyrur nga persona të rritur, të cilët nuk ishin familjarë apo të afërm të tyre. Të gjitha të ardhurat që përfitonin shkonin për personat e rritur. Këta fëmijë vinin nga familje me probleme të theksuara sociale dhe ekonomike.

Nga punonjësit e policisë nuk u realizua procesi i identifikimit si “viktima të mundshme” apo “viktima trafikimi” (konkludimi me intervistë formale apo joformale), apo të referoheshin në Zyrën e Kundër trafikëve të paligjshme ku të zhvillohej procesi identifikimit. Nga ana e policisë, ata nuk u informuan dhe nuk u referuan në ndonjë program, por u informuan nga ana e punonjësës, për shërbimet që ofronte qendra.

Praktika pozitive që vihen re në punën e policisë:

- Respektimi pjesërisht i të drejtës për t’u informuar.
- Prezenca e psikologut gjatë procesit të pyetjeve.

PROBLEMATIKA	SI DUHET VEPRUAR
Hyrja-dalja e punonjësve të policisë të tjerë në ambientin ku zhvillohej intervistimi i të miturve.	Gjatë intervistimit duhet të shmangen hyrjet dhe daljet e personave/punonjësve të policisë (të tjerë), pasi kjo mund të shpërqëndrojë, krijojë konfuzion apo ankth tek të personat që intervistohen, aq më tepër kur ata janë të mitur.
Punonjësi i policisë nuk ka patur njohuri mbi PSV-të dhe/ose i ka neglizhuar ato duke mos bërë referimin pranë strukturave përkatëse.	Në rastet kur gjatë intervistimit të të miturve (deklarimeve), dalin tregues të viktimave të mundshme të trafikimit të përcaktuara në PSV, punonjësit e policisë duhet të kryejnë veprimet si më poshtë: - Bëjnë një vlerësim të nevojave dhe ofrohet ndihma/mbrojtja e mundshme,

	<ul style="list-style-type: none"> - Informojnë dhe shpjegojnë të miturit/ prindit mbi të drejtat që viktimat e mundshme të trafikimit kanë dhe pyesin nëse pranojnë të intervistohen nga punonjës policie të strukturave kundër trafikeve të paligjshme (SKTP). - Nëse i mituri/prindi pranon, njoftohet SKTP, dhe informohet mbi rastin, duke plotësuar dhe dokumentacionin përkatës. - Nëse i mituri/prindi nuk pranon të intervistohet nga punonjësit e SKTP'së, përpilohet Informacion për Njoftimin Fillestar. - Në çdo rast njoftohet menjëherë gojarisht dhe më pas me shkrim Autoriteti Përgjegjës.
Ka patur shumë të pranishëm gjatë procesit të intervistimit të të miturve (deklarimit).	Në rastet e intervistimit të të miturve është e mjaftueshme prezenca e psikologut dhe prindërve të tyre. Madje kur bëhet fjalë për shfrytëzim apo shtytje të të miturve në krim duhet të shmanget dhe prezenca e prindërve kur një gjë e tillë është në interes të të miturit.
Mos informimi i të miturve dhe/ ose prindërve për mundësinë e marrjes së shërbimeve nga qendra sociale dhe/ ose institucionet përkatëse.	Në rastin konkret të miturit përveç të qenit autorë të vjedhjeve janë viktimat të shfrytëzimit dhe punonjësi i policisë duhet të kishte informuar të miturit dhe/ ose prindërit për ndihmën që mund t'ju ofrohej nga institucione/organizata të ndryshme.

Rasti 5

Nuk ishte hera e parë që shtetasja **D**, i drejtohej strukturave të Policisë, për shkak të dhunës së vazhdueshme fizike, që bashkëjetuesi i saj ushtronte mbi të. Këtë herë, ajo ishte larguar së bashku me dy fëmijët e saj, 3 vjeç dhe 6 muajsh, në kushtet e një dhune fizike ekstreme, ku ajo ishte e kërcënuar për jetën. Ishte e vendosur që nuk do të kthehej më tek ai.

Pasi shkoi në polici, për të kërkuar mbrojtje dhe për të gjetur një zgjidhje, oficeri i rojës e drejtoi në Zyrën kundër dhunës dhe aty bëri denoncimin kundër bashkëjetuesit. Gjatë procesit të denoncimit ishin dy oficerë policie, të cilët bënë pyetje dhe një oficerë policie, që bënte disa telefonata gjatë kësaj kohe. Në përfundim të denoncimit, oficerët e policisë i thanë shtetases se ajo duhej t'i nënshtrohej një vizite mjeko - ligjore. Pasi morën dokumentin nga mjeku ligjor, oficerët e policisë i komunikuan, se do të merrte nga Gjykata urdhrin e Mbrojtjes ndaj dhunuesit.

Më pas, oficerja e policisë i tha se duhet të priste në polici, deri sa të vinte një përfaqësuese nga një qendër, për ta akomoduar së bashku me fëmijët, pranë kësaj qendre. D. mendonte se gjetja e një strehe të përkohshme ishte shumë pozitive për situatën ku ndodhej.

Brenda një gjysmë ore qëndrimi në korridorin e ndërtesës së Policisë, në gjendjen kur djalin e vogël e kishte zënë gjumi në stolin e korridorit dhe kur D. i duhej të kujdesej edhe për djalin tjetër, i cili vraponte korridoreve, erdhi punonjësja e qendrës.

D. po priste me padurim, që të shkonte në qendër për të rehatuar fëmijët dhe veten, pas situatës rraskapitëse. Kishin kaluar një natë pa gjumë dhe fëmijët i kishte marrë uria.

Punonjësja erdhi dhe bisedoi për një kohë të shkurtër me shtetasen për nevojat e saj dhe më pas bisedoi me oficeren e policisë aty në korridor. Oficerja u largua përsëri dhe punonjësja u interesua më shumë për situatën e shtetases. Ajo i tregoi se bashkëjetuesi e kishte nisur dhunën duke i kërkuar që të dilte të shiste trupin, për të fituar të ardhura. Pas refuzimit nga ana e saj, ai e kishte goditur egërsisht me shkelma e grushte. Kishte përdorur majën e kaçavidës, duke e gjakosur në trup dhe duke e kërcënuar për jetën, nëse nuk do të punonte në rrugë. Kur bashkëjetuesin e kishte zënë

gjumi, ajo largohet nga shtëpia, duke marrë edhe fëmijët dhe drejtohet në polici.

Punonjësja e pyeti nëse e kishte raportuar këtë gjë në polici dhe viktimja i tregon, se në denoncimin që kishte bërë, i kishte thënë të gjitha, edhe këtë fakt. Më pas ajo strehohet në qendër së bashku me dy fëmijët e saj.

Praktika pozitive që vihen re në punën e policisë:

- Bashkëpunimi me qendrën për akomodimin e shtetases.
- Informimi i shtetases të dhunuar mbi akomodimin e saj në një qendër

PROBLEMATIKA	SI DUHET VEPRUAR
Neglizhencë ndaj viktimës të dhunës në familje në herët e mëparshme të paraqitjes së saj në strukturat e policisë.	Në çdo rast të paraqitjes së një ankese për dhunë në familje, duhet të informohet viktimja mbi të drejtën ligjore dhe procesin që mund të ndiqet për trajtimin/zgjidhjen e rastit. Në rastet kur dhuna është e përsëritur punonjësit e policisë duhet të ndjekin rrugën ligjore kryesisht edhe nëse viktimja nuk dëshiron.
Prezenca e më tepër se ç'duhej të punonjësve të policisë gjatë intervistimit si dhe kryerja e bisedave telefonike gjatë zhvillimit të këtij procesi.	Intervistimi i viktimës duhet të kryhet me praninë e jo më tepër se dy punonjësve të policisë, dhe gjatë intervistës duhen shmangur bisedat telefonike apo hyrje - daljet e shpeshta në ambientin ku zhvillohet intervistimi.
Mos informimi i viktimës mbi të drejtat e saj dhe procesin ligjor që do të ndiqet (urdhrit e mbrojtjes, referimin, etj.).	Është e domosdoshme që viktimave të dhunës në familje t'i shpjegohen të drejtat, mbrojtjen që mund apo do ti ofrohet si dhe procedura që do të ndiqet gjatë gjithë procesit në vijim.

<p>Nuk del qartë nëse është kryer vetëm procedura për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje apo janë kryer dhe veprimet procedurale për veprat penale respektive.</p>	<p>Në rastet e dhunës fizike, kanosjes, rastet e përsëritura, etj, përveç procedurës për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje, duhet domosdoshmërisht të kryhen veprime procedurale dhe materialet të referohen në prokurori. Madje në të tilla raste, duhet të kushtohet një kujdes i veçantë dhe duhet parë mundësia për aplikimin e masave të sigurimit personal ndaj dhunuesit (arrest në flagrancë).</p>
<p>Punonjësi i policisë nuk ka patur njohuri mbi PSV-të dhe/ose i ka neglizhuar ato duke mos bërë referimin pranë strukturave përkatëse.</p>	<p>Në rastet kur gjatë intervistimit, deklarimeve apo kallëzimeve të bëra nga viktima të dhunës në familje, dalin tregues të viktimave të mundshme të trafikimit të përcaktuara në PSV, punonjësit e policisë duhet të kryejnë veprimet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informojnë viktimën e dhunës në familje, se ajo mund të jetë njëkohsisht dhe viktimë trafikimi, - Shpjegojnë të drejtat që viktimat e mundshme të trafikimit kanë dhe pyesin nëse dëshiron të intervistohet nga punonjës policie të strukturave kundër trafikëve të paligjshme (SKTP). - Nëse viktima pranon njoftojnë SKTP, e informojnë mbi rastin, duke plotësuar dhe dokumentacionin përkatës. - Nëse viktima nuk pranon të intervistohet nga punonjësit e SKTP'së, përpilohet Informacion për Njoftimin Fillestar. - Në çdo rast duhet të njoftohet menjëherë gojarisht dhe më pas me shkrim Autoriteti Përgjegjës.

